



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008 e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr. 03/L-049, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.27/2008, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b) lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 31.08.2022 miraton këtë:

## V E N D I M

Për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022 në projektet kapitale .

### Neni 1

**1.1** Në bazë të Ligjit të Buxhetit NR.08/L-066 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2022 nga Rezervat e projekteve kapitale që duhet të buxhetohen në projekte kapitale është shuma prej **624,989.00€ (510,000.00€+114,989.00€)** e që në total i bie shuma prej **624,989.00€** si rezervë e cila duhet të kalojë në kategorinë aktive të projekteve kapitale.

**1.2** Shuma e lartshënuar do të transferohet- alokohet në këto projekte kapitale të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret sipas UA-NR.04/2019 dhe UA-NR.06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale e që tani konsiderojmë se janë plotësuar kërkesat e Udhëzimeve Administrative në fjalë.

### Neni 2

Lista e projekteve kapitale që kalojnë nga Rezervat në projekte kapitale për vitin fiskal 2022.

Programi	Kodi i Programit	Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	10-BKK 2022	21-THV 2022	Totali 2022
<b>624180-Sherbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia</b>						
<b>180120-Infrastruktura Rrugore-Suhareke</b>						
180	18012	52024	Projektet me bashkëfinancim	100,000.00	45,000.00	145,000.00
470	47012	52024	Projektet me bashkëfinancim		59,989.00	59,989.00
160	16623	52024	Projektet me bashkëfinancim		10,000.00	10,000.00
<b>Totali -Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia</b>				<b>100,000.00</b>	<b>114,989.00</b>	<b>214,989.00</b>
<b>624470-Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural</b>						
<b>470120-Bujqësia -Suharekë</b>						
470	47012	Projekt I Ri	Ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit në rrugën "Skënderbeu"-Suharekë	410,000.00		410,000.00
<b>Totali -Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural</b>				<b>410,000.00</b>		<b>410,000.00</b>
<b>T OTALI KOMUNAL :</b>				<b>510,000.00</b>	<b>114,989.00</b>	<b>624,989.00</b>



### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren(QRK) Nr.06/2021 të dates 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-57287  
Me datë 31.08.2022



Kryesuesi Kuvendit  
Bexhet Kuçi  
Bexhet KUÇI